

Zhvillohet në KLSH takimi i Iniciativës për Zhvillim – IDI, për Strategjinë e Matjes dhe Raportimit të Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit

Në datat 17 deri më 19 tetor 2023, në Kontrollin e Lartë të Shtetit u zhvillua takimi SPMR III, organizuar nga IDI (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t) për Strategjinë e Matjes dhe Raportimit të Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit.

Takimi synonte parapërgatitjen e personave të kontaktit të përzgjedhur nga IDI mbi ndryshimet dhe të rejat e SPMR III (Strategic Planning, Monitorin and Reporting), si dhe informacione paraprake mbi SAI-et që do të marrin pjesë në këtë fazë nëpërmjet kryerjes së vetëvlerësimit të performancës (SAI - PMF), hartimit të planit strategjik dhe operacional, si dhe ngritjen e sistemit të monitorimit dhe raportimit mbi këto dokumente. Kjo iniciativë synon të mbështesë Institucionet Supreme të Auditimit në Matjen e Performancës dhe Iniciativën Raportuese.



Në takimin e punës të zhvilluar në mjediset e KLSH-së ishin të pranishëm përfaqësues nga IDI, z. Laurent Grosse-Kozłowski dhe znj. Nino Tsintsadze, si dhe auditues nga SAI të ndryshme, si: Serbia, Indonezia, Zambia, Kamerun, Tunizia, Kosta Rika, AFROSAI.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga znj. Xhuljeta Çelaj, si person kontakti i përzgjedhur nga IDI për fazën e tretë dhe të katërt të SPMR. Duhet theksuar se KLSH e përfundoi me sukses SPMR vitin e kaluar duke përmbyllur raportin e vetëvlerësimit të performancës, hartimin e planit strategjik dhe operacional të institucionit.



Menaxhimi strategjik ka qenë gjithmonë i rëndësishëm në nxitjen e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, që ndikojnë pozitivisht në cilësinë e qeverisjes së sektorit publik dhe ofrimit të shërbimeve në përfitim të të gjithë qytetarëve.

Faza e parë e SPMR, e cila përfshinte dy raunde dhe zgjati për 5 vjet, ka ndihmuar deri në 50 SAI në mbarë botën për të përmirësuar qeverisjen e tyre. Duke u mbështetur në suksesin e fazës së fundit, një marrëveshje e re financimi 5-vjeçare është nënshkruar ndërmjet Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe IDI. Programi i ri ka një shtrirje më të gjerë që përfshin mbështetjen për qeverisjen e SAI-t dhe pavarësinë e SAI-t, për përgjegjshmëri dhe integritet më të fortë të sektorit publik.

Duke marrë parasysh këto avancime, roli i personave të kontaktit (Resource Persons) është bërë edhe më i rëndësishëm, pasi edhe nëpërmjet suportit të tyre, IDI synon të zgjerojë impaktin e kësaj iniciative edhe në shumë institucione supreme auditimi.